



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 111
Prishtinë, më 27, 28 dhe 31 maj 2010

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27, 28 DHE 31 MAJ 2010

Seancën e drejtoi **Sabri HAMITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar si çështje urgjente ratifikimin e marrëveshjes të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ta arsyetojë marrëveshjen.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci tha se Komisioni ka shqyrtuar marrëveshjen e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,

e cila është e ndarë në ka dy pjesë të veçanta. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta shqyrtojë dhe miratojë këtë marrëveshje.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare për propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Gani Koci tha se mbështet propozimin e Komisionit.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi tha se e mbështet propozimin.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi tha se nuk mbështet propozimin e Komisionit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makoli tha se abstenojnë nga votimi për këtë propozim.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxheri tha se nuk mbështet propozimin e Komisionit.

Në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, Sadik Idriz tha se mbështet propozimin e Komisionit.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletijq tha se mbështet propozimin e Komisionit dhe

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branisllav Grbiq tha se mbështet propozimin e Komisionit.

Pas këtyre deklarinimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-- shumica absolute,
Kundër-----18,
Abstënime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e Komisioni për Buxhet dhe Financa që në rend dite të radhitet edhe ratifikimi i marrëveshjes të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA).

Grupi Parlamentar i LDD-së kishte kërkuar që Kuvendi, në seancën e sotme, si çështje urgjente, të diskutojë për cenimin e integritetit dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar i LDD-së ta arsyetojë kërkesën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli tha se duke parë se zhvillimet në vend, që kanë të bëjnë me Kushtetutën, ligjshmërinë dhe ushtrimin e sovranitetit, në 30% të territorit të Republikës nuk njohin trendë pozitiv, por përkundrazi, kanë vetëm përkeqësim. Andaj, propozojmë që Kuvendi sot të diskutojë për këtë çështje dhe në fund të diskutimeve ta nxjerrë një rezolutë.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare për kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, u deklarua Ramë Buja, nga Grupi Parlamentar të LDK-së, Ramë Manaj; në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi ; në

emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli; në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, Enis Kervan; në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branislav Grbiq.

Pas këtyre deklarimeve, kryesuesi hodhi në votim kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për--shumica absolute,
Kundër-----2,
Abstenime ----- asnjë

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së që në rend dite të seancës së sotme, të radhitet edhe: Cenimi i integritetit dhe i sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R E N D D I T E

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit
5. Ratifikimi i marrëveshjes të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,
6. Votimi për Raportin e Agjencisë së Privatizimit,
7. Votimi për Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore,
8. Debati për cenimin e integritetit dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ripranim,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës,
14. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009,
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
17. Propozimet e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë:

Driton Tali, Mark Krasniqi, Naim Rustemi, Nekibe Kelmendi, Riza Smaka, Arsim Bajrami dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës plenare, të mbajtur më 13 maj 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj lidhur me tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative.

Ministri Enver Hoxhaj mungoi.

Deputeti **Ibrahim Makolli** parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Bujar Bukoshi lidhur me riparimin e **dy CV**-ve të vjetra

Ministri Bukoshi iu përgjigj pyetjes së deputetit Makolli.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj** parashtoi pyetje për kryeministrin Thaçi lidhur me akuzat për korrupsion në Qeverinë e Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Demaliaj.

Deputeti **Driton Tali** parashtoi pyetje për ministrin e Tregtisë, Lutfi Zharku lidhur me punën e kompanisë “Derivati”, e cila bën kontrollin e cilësisë së naftës në pikën doganore të Hanit të Elezit.

Ministri Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtoi pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar lidhur me operimet ilegale që bëjnë kompanitë duke shkatërruar ambientin.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti **Rexhep Hoti** parashtoi pyetje për kryeministrin Thaçi lidhur me privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Hoti.

Deputeti **Danush Ademi** parashtoi pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies sociale, Nenad Rashiq lidhur me memorandumun e nënshkruar për ndërtimin e 40 shtëpive për raste sociale në fshatin Dubravë.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Ademi.

Deputeti **Abdyl Ymeri** parashtoi pyetje për ministrin e Drejtësisë, Haki Demolli lidhur me procesin e reformave në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Ministri Demolli iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Deputeti **Gani Geci** parashtoi pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Lutfi Haziri lidhur me uzurpimin e korridoreve të Teatrit të Qytetit të Gjilanit.

Ministri Lutfi Haziri mungoi.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kosovës në Konferencën e Sarajevës e organizuar nga BE, kushtuar Ballkanit Perëndimor.

Ministri Hyseni iu përgjigj pyetjes së deputetit Kurteshi.

Deputeti **Bahri Hyseni** parashtoi pyetje për kryeministrin Thaçi lidhur me procedimin e dy projektligjeve, Projektligjit për të drejtat e familjeve të dëshmoreve dhe Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor.

Zv. kryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputetja Qamile Morina parashtoi pyetje për kryeministrin Thaçi lidhur me ekzistimin e një strategjie për integrimin e pjesës veriore.

Zv. kryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Pika e 4-të, Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit dhe pika 5-të, - Ratifikimi i marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrë, në mungesë të kuorumit, u prolonguan për më vonë.

6. Votimi për Raportin e Agjencisë së Privatizimit

Kuvendi, në seancën e mëparshme kishte debatuar për Raportin e Agjencisë së Privatizimit, por, në mungesë të kuorumit, kishte mbetur pa u votuar. Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Agjencisë së Privatizimit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër--- 18,
Abstenime 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e Agjencisë së Privatizimit, për vitin 2009.

7. Votimi për Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore

Kuvendi, në seancën e mëparshme kishte debatuar për Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore, por, në mungesë të kuorumit, kishte mbetur pa u votuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër---- 8,
Abstenime 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore.

8. Debat i për cenimin e integritetit dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Kryesuesi ftoi propozuesin e debatit që ta marrë fjalën.

Deputetja **Besa Gaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së tha se Kushtetuta e Republikës së Kosovës duhet të zbatohet në tërë territorin e vendit, por ajo nuk është duke u zbatuar, sepse po shkelet sovraniteti dhe integriteti i vendit. Në një pjesë të vendit po hyjnë njerëz të armatosur nga Serbia, pa u kontrolluar dhe pa u penguar nga askush. Andaj, për të mos dalë situata jashtë kontrollit duhet që institucionet e Kosovës të ndërmarrin veprime konkrete, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, që ta shtrijnë rendin dhe kontrollin në tërë territorin e vendit.

Lidhja Demokratike e Dardanisë, në mënyrë institucionale, kërkon para se situata të eskalojë, të marrë qëndrim për ndalimin e zgjedhjeve që planifikohen të organizohen nga ana e Serbisë në territorin e Kosovës.

Kuvendi, duhet t'i obligojë organet për zbatimin e ligjit që, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, që është i pranishëm në Kosovë, ta vënë rendin dhe sigurinë në tërë territorin e vendit.

Pastaj, kryesuesi hapi diskutimin lidhur me mocionin e parashtruar nga Grupi Parlamentar i LDD-së.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Rexhep Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiç, si dhe deputetët: Melihate Termkolli, Gani Koci, Ibrahim Makolli, Sabri Hamiti, Rustem Mustafa, Fatmir Rexhepi, Drita Maliqi, ministri Bajram Rexhepi, Riza Smaka, Emrush Xhemajli, Lulzim Zeneli, Bahri Hyseni, Ibrahim Selmanaj, Qamile Morina, Naim Rustemi, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, kryeministri Hashim Thaçi, Nekibe Kelmendi, Driton Tali, Gani Buçinca, Kaqusha Jashari, Suzan Novoberdaliu, Edita Tahiri, Hydajet Hyseni, Esat Brajshori, Branislav Grbiq, Zef Morina dhe Sllobodan Petroviq që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund të këtij debati, **kryesuesi** ia dha fjalën propozuesit të mocionit.

Lulzim Zeneli tha se në konsultim me përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare jemi pajtuar për tekstin si në vijim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke demonstruar rolin kushtetues dhe vendosmërinë në mbrojtje të kushtetutshmërisë, integritetit dhe sovranitetit të vendit, në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.5.2010, pas debatit parlamentar merr këtë

Q Ë N D R I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në koordinim me faktorët relevant ndërkombëtarë t'i ndalojë aktivitetet të cilat zhvillohet në territorin e Republikës së Kosovës, jashtë sistemit politik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës, duke përfshirë:

1. Marrjen e masave për ndalimin e organizimit të zgjedhjeve lokale dhe ushtrimit të veprimtarive të Qeverisë së Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë, ndalimin e vizitave të zyrtarëve të Republikës së Serbisë, pa lejen e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe
2. Hartimin e planit aksionar, në koordinim me faktorët e tjerë relevantë, për zhbërjen e strukturave të pushtetit të Qeverisë së Republikës së Serbisë në veri të Republikës së Kosovës.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e tekstit të lartshënuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----0 ,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi qëndrimin e lartshënuar për Cenimin e integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Skënder Hyseni tha se miratimi i këtij projektligji në Kuvend paraqet një hap tjetër të rëndësishëm në funksionalizimin e shërbimit diplomatik të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është thjeshtësimi i procedurave me rastin e emërimit të ambasadorëve dhe të konsujve, drejt krijimit të një shërbimi diplomatik profesional dhe të përgjegjshëm, tha ai.

Në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Jashtme dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hydajet Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sllobodan Petroviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branislav Grbiç, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----0 ,
Abstenime-----Asnjë

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Jashtme, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi, Sabri Hamiti pas pëlqimit të Kuvendit konstatoi se seanca plenare për ditën e sotme ka përfunduar, kurse vazhdimi i saj bëhet më 28 maj 2010, e premte, në orën 10. Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:40 minuta.

E premte, 28 maj 2010, në orën 10, Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e drejtoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë, ndërsa i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Sabri Hamiti, në fillim të vazhimit të seancës plenare, në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shprehu përgëzimet për institucionet e Republikës së Shqipërisë, në lidhje me rekomandimin e Komisionit Evropian për heqjen e vizave, për qytetarët e Shqipërisë.

Kuvendi i vazhdoi punimet me shqyrtimin e pikës nr. 8 të rendit të ditës,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ripranim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Ripranim.

Bajram Rexhepi tha se hartimi i këtij projektligji ka filluar nga muaji shkurt i këtij viti dhe në këtë proces janë përfshirë edhe ekspertë nga EULEX-i, ICITAP-i, UNHCR-ja etj, kurse mbështetje e veçantë ka ofruar edhe Komisioni Evropian.

Nevoja për këtë projektligj është mjaft e madhe, aq më parë kur dihet se nxjerrja e një ligji të tillë është njëri nga kriteret për liberalizimin e vizave nga ana e BE-së, për qytetarët e Republikës së Kosovës, tha ai.

Në vazhdim tha se nëpërmjet këtij projektligji synohet përmirësimi i rregullativës ligjore për ripranimin e qytetarëve tanë, të cilët gjenden jashtë vendit, pa status të rregulluar. Ai potencoi të dhënë se ky projektligj nuk ka efekte shtesë buxhetore, në ndërkohë që, Ministria që ai drejton, me buxhetin aktual do të jetë në gjendje të absorbojë ndonjë nga efektet eventuale të natyrës financiare.

Ministri Rexhepi më tej tha se projektligji është në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së, kurse në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për Ripranim.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Ripranim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Danush Ademi, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Rexhep Hoti, Riza Smaka, Xhevdet Neziraj, Njomza Emini, Adem Hajdaraj dhe Gani Koci, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Ripranim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Lutfi Zharku tha se arsyeja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji qëndron në faktin se ligji aktual ka pasur disa paqartësi në dispozitat kalimtare, ngase ai nuk i shfuqizonte disa rregullore të UNMIK-ut, rrjedhimisht ndryshimet e parapara do ta bënin më të zbatueshëm këtë ligj.

Në vazhdim tha se nëpërmjet këtij projektligji synohet heqja e të gjitha taksave për regjistrimin e biznesit, janë thjeshtuar procedurat për këtë qëllim, si dhe është paraparë zvogëlimi i deponimit të kapitalit fillestar. Më tej tha se është bërë përcaktimi i saktë i

personave fizikë dhe atyre juridik dhe i pjesëtarëve të familjeve të tyre, është zvogëluar kapitali fillestar për regjistrimin e shoqërive aksionare, nga 25 mijë € në 10 mijë €, si dhe është bërë përshtatshmëria e terminologjisë juridike të shoqërive tregtare.

Në fund ministri Zharku i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për shoqëritë tregtare.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për shoqëritë tregtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliç, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Zef Morina, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Riza Smaka, Hydajet Hyseni dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ahmet Shala tha se në draftimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë edhe ekspertë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në vazhdim tha se në këtë projektligj përfshihen elemente të ligjeve moderne, për krijimin e një stabiliteti më të theksuar financiar në vendin tonë.

Më tej tha se nëpërmjet këtij projektligji adresohen disa çështje siç janë: nxitja e sektorit financiar në ruajtjen e çmimeve, likuiditeti i bankave komerciale, qeverisja e BQK-së, zgjedhja dhe shkarkimi i Bordit të BQK-së dhe guvernatorit të saj etj. Projektligji ka 16 kapituj me 81 nene, tha ministri, kurse në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Fatmir Rexhepi, Naim Rustemi, Driton Tali, Armend Zemaj, Nerxhivane Dauti, Myrvete Pantina, Rita Hajzeraj, Adem Hajdaraj dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Mahir Yagcilar tha se në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës së re ligjore, Ministria që ai drejton, prezanton sot Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Ligji ekzistues tha ai nuk i trajton disa çështje, veçmas ato nga mbrojtja e natyrës së faunës së egër.

Ky projektligj adreson disa çështje, siç janë ato për llojet e bimëve, shtazëve, shfrytëzimin racional të natyrës, mënyrën e parandalimit të ruajtjes së natyrës si pasojë e zhvillimit teknologjik, nxjerrjen e dokumenteve strategjike nga kjo lëmi, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e natyrës sipas koncepteve bashkëkohore, zonat e veçanta, peizazhin e mbrojtur, masat ndëshkimore për shkeljet nga kjo fushë, etj.

Në vazhdim tha se projektligji është në harmoni me Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe në draftimin e tij janë marrë në konsideratë rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë. Në fund ministri tha se për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore dhe ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elheme Hetemi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së,

Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Shpresa Murati, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Teuta Hadri, Luljeta Shehu, Ibrahim Selmanaj, Driton Tali, Berat Luzha, Njomza Emini, Mark Krasniqi, Zylfi Merxha, Gani Buqinca, Armend Zemaj, dhe Mahir Yagcilar, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër-----2,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Propozimet e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi kërkoi nga Kuvendi që përmes një votimi formal me ngritje dore, deputetët të deklarohen për Propozimin e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kuvendi miratoi kërkesën e grupeve parlamentare.
Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

I. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, në komisionet parlamentare emërohen:

1. Deputeti Rexhep Hoti, anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetit Zafir Berisha.
2. Deputeti Arsim Bajrami, anëtar i Komisionit për Integritet Evropian, në vend të deputetes Edita Tahiri.
3. Deputeti Adem Grabovci, anëtar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në vend të deputetes Nerxhivane Dauti.
4. Deputeti Ismail Kurteshi, anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të deputetit Memli Krasniqi.
5. Deputeti Abdyl Ymeri, anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në vend të deputetit Hajdin Abazi.
6. Deputeti Basri Musmurati, anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetit Zafir Berisha.

II. Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, në komisionet parlamentare emërohen:

1. Deputeti Fatmir Rexhepi, kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetit Ismet Beqiri.
2. Deputetja Njomza Emini, zëvendëskryetare e parë e Komisionit për Integritet Evropian, në vend të deputetit Bujar Bukoshi.

III. Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, në komisionet parlamentare emërohen:

1. Deputetja Melihate Termkolli, anëtare e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në vend të deputetit Ahmet Isufi.

Kryesuesi, **Sabri Hamiti** pas pëlqimit të Kuvendit konstatoi se seanca plenare për ditën e sotme ka përfunduar, kurse vazhdimi i saj bëhet më 31 maj 2010, e hënë, në orën 10. Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:40 minuta.

E premte, 31 maj 2010, në orën 10, Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kuvendi i vazhdoi punimet me shqyrtimin e pikës nr. 12 të rendit të ditës,

15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2009

Deputetja **Selvije Halimi**, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin të punës së Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2009, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo tha se realizimi i ndihmës juridike falas, tregon përkushtimin e institucioneve për ruajtjen e sundimit të ligjit në vend.

Më tej tha se Komisioni në vitin 2009 ka hapur pesë zyra regjionale në Kosovë, kurse si prioritet të këtij Komisioni përmendi procedimin e Projektligjit për ndihmë juridike si dhe ristrukturimin e këtij Komisioni. Ajo në fund përkrahu Raportin të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009,

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet,

Vezira Emrush, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Riza Smaka dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009.

16. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009,

Deputetja **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, arsyetoi para deputetëve të Kuvendit, Raportin me rekomandime, për Raportin e punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Sala Berisha – Shala, Sanije Aliaj, Driton Tali, Suzan Novoberdaliu, Abdyl Ymeri, Myrvete Pantina dhe Berat Luzha, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----5,
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009.

17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Deputeti **Hajredin Hyseni**, në emër të Komisionit Ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, arsyetoi para deputetëve të Kuvendit, Raportin me rekomandime.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Rekomandimit të Komisionit Ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Rekomandim dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Rekomandimit të Komisionit Ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

I. Anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media emërohen:

1. Daut Demaku,
2. Venera Hajrullahu.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjatë dy (2) vjet.

Kryetari në vazhdim tha se Kuvendi, ka në rend dite votimin e dy pikave: Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, dhe Ratifikimin e marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim.

4. Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit

Kryetari e hodhi në votim Harmonizimin e nenit 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----84,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi harmonizimin e nenit 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

5. Ratifikimin e marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim

Kryetari e hodhi në votim Ratifikimin e marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----15,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e nuk e ratifikoi marrëveshjen e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale